

ERTRIT SOFRONI

Mban pozicionin e Këshilltarit Ligjor, në Njësinë e Mbështetjes së Komisioneve të Departamentit Ligjor në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga viti 2019 e në vijim.

Është diplomuar me titullin “Jurist” në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës në vitin 2005. Në vitin 2013, ka përfunduar programin e studimeve Master i Nivelit të Dytë, pranë “Institutit të Studimeve Europiane”, pranë Rektoratit të Universitetit të Tiranës në profilin “Studime për Legjislacion dhe Institucione të BE - së”.

Ka një eksperience 15 vjeçare në administratën publike dhe gjatë karrierës së tij është angazhuar në një larmi detyrash në cilësinë e juristit, si hartim aktesh administrative të brendshme, hartim aktesh ligjore dhe nënligjore, hartim dhe negocim kontratash, përfaqësim në gjykatë, Auditim, Inspektim, angazhim në veprimtari me karakter mbështetës të institucioneve, etj.

Nga viti 2006 deri në vitin 2007, ka ushtruar funksionin e Kancelarit në Prokurorinë pranë Gjyaktës së Shkallës së Parë Kavajë, më pas, nga viti 2007 deri në vitin 2008 ka mbuluar detyrën e juristit në Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare dhe 2008 deri 2009 atë të juristit në Byronë Shqiptare të Sigurimeve. Nga viti 2009 deri në vitin 2013 është emëruar fillimisht Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit dhe Menaxhimit të Kontratave e në vijim Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Nga viti 2014 deri në vitin 2016, ka mbuluar detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Nga viti 2016 e deri në vitin 2019 ka mbuluar detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

Gjatë Karrierës së tij z.Sofroni ka qenë pjesë e grupeve të punës për hartimin e akteve të ndryshme ligjore si dhe përfaqësues i Institucioneve të ndryshme në borde dhe komitete.

Z.Sofroni ka pasur edhe angazhim si trajner prej gati 4 vjetësh për llogari të Albanian School of Public Administration (ASPA) dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ka marrë pjesë në trajnime dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit.

Zotëron njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe italiane.